



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-17778 dt. 18/05/ 2026

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42, neni 44 pika 44.4 dhe pika 44.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit të Drenasit, kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

th ë r r e t

mbledhjen e **katërt** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **datë: 25.05.2026** e cila do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e bordit të drejtorive, (kati tretë) i Komunës Drenasit.

Për mbledhje propozohet ky:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politike dhe Financa i datës: 21.04.2026.
2. Të ndryshme

Drenas, 18.05.2026



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Burim Bujupi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr 060/04-16227 dt. 05/05/2026

PROCESVERBAL

I mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 21.04.2026, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KPF-së: Burim Bujupi, kryesues i Kuvendit, Fitore Morina-Hoxha (PDKRLL), Selman Çallapeku (PDKRLL), Pajtime Berisha (PDK), Arigon Sinani (PDK) dhe Arbër Halilaj (BD).

Mungoi: Egzona Tërdevci (VV).

Të pranishëm ishin edhe: Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës, Enver Hoxha, drejtor i Drejtorisë së Financave, Muhamet Gjoka, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Kaltrina Qerkinaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Afije Veseli, shefe e Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Burim Bujupi**, Kryesues i Kuvendit.

RENDI I DITËS

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politike dhe Financa i dt. 18.03.2026;
2. Propozim - vendim për miratimin e Planit lokal të veprimit në mjedis 2026-2030;
3. Propozim - vendim për miratimin e Planit komunal për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Drenasit/Gllogocit 2026-2028;
4. Propozim - vendim për lejimin e bonusit të banimit për shfrytëzimin e banesave me qira nga tregu, për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare të bëjnë pagesën e qirasë;
5. Propozim - vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për drejtor në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Drenasit;
6. Raporti financiar janar-mars 2026;

7. Propozim - vendim për themelimin e Komisionit për vlerësimin e pronave të përfshira në vendimin nr.02-462/01-77929 të dt. 27.02.2026 për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (deri 99 vite);
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi pasi përshëndeti të pranishmit, hapi diskutimin për rendin e ditës.

Arbër Halilaj propozoi që, në ndërlidhje me pikën 7 të formohet edhe një komision për shqyrtimin e ankesave me mandat dyvjeçar, ashtu siç kërkohet me Ligjin për dhënien e pronave në shfrytëzim.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi sqaroi se, fillimisht formohet komisioni për vlerësimin e pronave të përfshira në vendimin nr. 02-462/01-77929, të dt. 27.02.2026, për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizikë/juridikë (deri në 99 vite). Ndërsa më pas, në një seancë të radhës, do të formohet edhe komisioni për shqyrtimin e ankesave.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci theksoi se, MAPL-ja ka kërkuar që ky komision të formohet me vendim. Ai shtoi se, nëse është e nevojshme do të konsultohet me juristët dhe më pas do të ndërmerren hapat përkatës për formimin e këtij komisioni.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi hodhi në votim rendin e ditës. Ky rend dite u rekomandua për Kuvend. Për votuan 5, kundër 0, abstenime 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e parë të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 18.03.2026. Pika e parë e rendit të ditës u miratua pa vërejtje.

Për votuan 5, kundër 0, abstenime 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Propozim-vendim për miratimin e Planit lokal të veprimit në mjedis 2026–2030. Meqenëse nuk pati diskutime, kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë, e cila u rekomandua për Kuvend.

Për votuan 5, kundër 0 abstenime 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Propozim-vendim për miratimin e Planit komunal për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Drenasit/Glllogocit për periudhën 2026–2028.

Shefja e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, Afije Veseli sqaroi se, ky plan i përket Zyrës për Komunitete dhe Kthim, e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit. Ajo theksoi se, plani bazohet në rregulloret e punës në fuqi për këtë zyrë dhe është hartuar nga një grup punues, ku kanë qenë të përfaqësuara të gjitha drejtoritë dhe zyrat relevante. Gjithashtu ajo shtoi se, ky plan

është vazhdimësi e planit për periudhën 2023–2025, pasi që rregulloret nuk kanë pësuar ndryshime.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi tha se, meqenëse nuk pati pyetje, konstatoi se edhe pika e tretë e rendit të ditës rekomandohet për Kuvend.

Për votuan 5, kundër 0 abstenime 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Propozim-vendim për lejimin e bonusit të banimit për shfrytëzimin e banesave me qira nga tregu, për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare për pagesën e qirasë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë, Kaltrina Qerkinaj theksoi se, programi komunal trevjeçar për banim ka për qëllim të ndihmojë familjet që nuk kanë mundësi financiare për të përballuar pagesën e qirasë. Ajo bëri të ditur se, janë përzgjedhur rreth 5 familje, kryesisht raste sociale. Sipas saj, nëse qiraja mujore për një familje është 200 euro, atëherë pagesa ndahet në mënyrë të barabartë: 100 euro mbulohen nga komuna dhe 100 euro nga familja.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi tha se, meqenëse nuk pati diskutime, e hodhi në votim pikën e katërt të rendit të ditës, e cila u rekomandua për Kuvend.

Për votuan 5, kundër 0 abstenime 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Propozim-vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për drejtorë në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Drenasit.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Muhamet Gjoka theksoi se, ky propozim-vendim vjen si rezultat i faktit që gjatë këtij viti ka disa pozita të lira për drejtorë dhe zëvendës drejtorë. Ai sqaroi se, sipas procedurave kërkohet miratimi i Kuvendit për përbërjen e komisionit përzgjedhës.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi pyeti se, kur përfundon mandati i këtyre anëtarëve.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Muhamet Gjoka tha se, dy anëtarë të komisionit propozohen nga niveli lokal, një nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) dhe një nga radhët e drejtorëve të shkollave me performancë të lartë ose nga Këshilli i Prindërve, ndërsa anëtari i tretë emërohet nga MASHT-i, për të cilin Komuna nuk ka kompetencë përcaktuese.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi e hodhi në votim pikën e pestë të rendit të ditës, e cila u rekomandua për Kuvend. Për votuan 5, kundër 0 abstenime 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Raporti financiar për periudhën janar–mars 2026. Lidhur me këtë pikë nuk pati diskutime nga anëtarët e komitetit. Kryesuesi sqaroi se, raportet financiare nuk hidhen në votim.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Propozim-vendim për themelimin e Komisionit për vlerësimin e pronave të përfshira në vendimin nr. 02-462/01-77929, të dt. 27.02.2026, për miratimin paraprak të Vendimit për

dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë për persona fizikë/juridikë (deri në 99 vite).

Arbër Halilaj pyeti Kryetarin lidhur me bashkëpunimin ndërmjet dy komisioneve, atij rekomandues – pjesë e të cilit është edhe ai dhe komisionit vlerësues. Njëkohësisht, ai propozoi që, me qëllim të përshpejtimit të procedurave, të formohet edhe një komision për shqyrtimin e ankesave.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci theksoi se, ky është një komision funksional i paraparë me ligj dhe si rekomandim nga MAPL-ja. Ai shtoi se, janë të obliguar që komisioni të përbëhet nga tre anëtarë nga Kuvendi, një nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile. Gjithashtu, ai garantoj transparencë dhe pjesëmarrje në çdo veprim të këtij komisioni, duke shprehur besimin se çdo gjë do të realizohet në të mirë të Komunës së Drenasit.

Arigon Sinani pyeti, nëse komisioni i formuar në mbledhjen e kaluar të Kuvendit i kryen të gjitha funksionet, apo nëse është i nevojshëm edhe një komision shtesë.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci sqaroi se, komisioni aktual është i përcaktuar me ligj, ndërsa komisioni i formuar në mbledhjen e kaluar ka pasur rol rekomandues për Kryetarin, lidhur me procedurat dhe orientimin e zhvillimit të komunës.

Arbër Halilaj theksoi se, komisioni vlerësues nuk duhet t'i anashkalojë rekomandimet e komisionit rekomandues, pasi ato janë të bazuara në analiza konkrete dhe duhet të merren parasysh. Ai shtoi se, komisioni vlerësues është organ zyrtar dhe i obligueshëm për çdo komunë, ndërsa komisioni rekomandues nuk është i detyrueshëm, por shërben për rritjen e transparencës.

Pajtime Berisha sqaroi se, njëri komision jep rekomandime, ndërsa komisioni tjetër bën vlerësimin e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi pasi nuk pati diskutime, e hodhi në votim pikën e shtatë të rendit të ditës, e cila u rekomandua për Kuvend.
Për votuan 6, kundër 0, abstenime 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi deklaroi se, me kërkesën e Arbër Halilajt dhe me aprovimin e Kryetarit, u propozua. Formimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave për pronat që jepen në shfrytëzim. Ky propozim u hodh në votim për t'u rekomanduar për Kuvend.
Për votuan 6, kundër 0 abstenime 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e tetë të rendit të ditës:
8. Të ndryshme.

Pajtime Berisha ngriti çështjen e banorëve të fshatrave Vasilievë dhe Poklek, të cilët janë të interesuar të dinë nëse do të rifillojë transporti për nxënësit dhe udhëtarët, pasi për shkak të një defekti ai nuk është duke funksionuar. Ajo theksoi se, banorët veçanërisht nxënësit e shkollës së mesme, janë të detyruar të ecin në këmbë çdo ditë dhe kërkojnë informatë nëse pritet rifillimi i transportit.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci u përgjigj se, aktualisht nuk ka informacion të saktë, por se do të sigurojë informacionin e nevojshëm. Ai shtoi se, nëse bëhet fjalë për kontratat që Komuna ka me kompanitë për bartjen e nxënësve, ekzistojnë vështirësi financiare, ndër të tjera edhe për shkak të mungesës së stafit përkatës.

Arigon Sinani kërkoi që në mbledhjen e rregullt të përfshihet një pikë shtesë, përmes së cilës të propozohet. Formimi i një komisioni për verifikimin e të gjitha lejeve të ndërtimit të lëshuara në Komunën e Drenasit, me theks të veçantë në ndërtimet e larta.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi tha se, lidhur me pyetjen që bëri Arigon Sinani, do të konsultohem me zyrën ligjore dhe do t'i kthejëm përgjigje.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi pasi konstatoi se nuk pati diskutime të tjera, e shpalli mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

Procesmbajtësja: Fakete Hoti

Lekturoi: Nikelinda Bujupi



Kryesuesi i Kuvendit

Burim Bujupi